



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 10132 Prot

Shkodër, më 15.06.2021

VENDIM

Nr. 215 Datë 15.06.2021

‘PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE’

Në mbështetje të neneve 8, 9 të ligjit nr.139/2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’ i ndryshuar; nenet 28, 29 të ligjit nr.44/2015 ‘Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë’ i ndryshuar

VENDOSA:

1.Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, z. Tonin Dedaj, me detyrë zëvendëskryetar i bashkisë Shkodër, për të firmosur çdo korrespondencë shkresore që ka të bëjë me institucionet publike, persona juridik / fizik dhe individëve për drejtoritë të cilat janë në varësi direkte të zëvendëskryetarit z. Tonin Dedaj, si më poshtë ;

- Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave
- Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe AMTP

2.Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, z. Tonin Dedaj, me detyrë zëvendëskryetar i bashkisë Shkodër, për të monitoruar dhe koordinuar punën për mbarëvajtjen e institucionit të varësisë dhe njësisive administrative, si më poshtë ;

- Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore.
- Njësitë administrative Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Gur i zi, Postribë, Pult, Rrethina, Shalë, Shosh, Velipojë.

3.Zëvendëskryetari nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca zyrtareve të tjerë.

4.Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet z. Tonin Dedaj, Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe AMTP, Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore, Njësitë administrative, Drejtoria Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbeshtetese, Sektori i Protokoll Arkivit të bashkisë Shkodër.

5.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen web të Bashkisë Shkodër.

KRYETAR


Voltana ADEMI

